



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**

**01Nr. 104/02-11398/24**  
**Kaçanik, 28.06.2024**

Në bazë të nenit 12.2. 14.1 lidhur me nenin 17 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ( Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 6 pika 1.2 lidhur me nenin 19 pika 3.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 –Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019 ), të dispozitave të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të nenin 6.2(h) të Statutit të Komunës, të Vendimit 01Nr. 104/02-32234/23 të datës 28.12.2023 për aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2024, të Vendimit Paraprak 01Nr. 350/01-4450/24 të datës 29.02.2024 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vjet, duke vendosur sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues 01Nr.104/02-11398/24,Ofertës01Nr.104/02-9281/24 (bashkangjitur) Oferta ekonomikisht me e favorshme, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 28 qershor 2024, mori këtë:

#### **VENDIM**

**Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetenëntë (99) vjet pronën e paluajtshme të komunës së Kaçanikut në Zonën Kadastrale Doganaj të Kaçanikut, përmes shprehjes së interesit, kompanisë ROYAL BENVERAGE LL.C nga f.Velekincë, me përfaqësues Fejzulla Mustafa**

1. Me këtë vendim, i Jepet në shfrytëzim afatgjatë – për nëntëdhjetenëntë (99) vjet, kompanisë **ROYAL BENVERAGE LL.C**, me përfaqësues Fejzulla Mustafa, adresa: f. Velekincë, Gjilan, prona e paluajtshme e komunës, në Zonën Kadastrale Doganaj, përmes shprehjes së interesit, në parcela kadastrale si vijon:
  - 1.1 Në Parcela Kadastrale Nr. P-70917026-00143-2 me kulturë Kullosë e Klasës 4 në sipërfaqe prej **01.50.01ha** në Zonën Kadastrale Doganaj;
  - 1.2 Në Parcela Kadastrale Nr. P-70917026-00143-4 me kulturë Kullosë e Klasës 4 në sipërfaqe prej **01.00.00ha** në Zonën Kadastrale Doganaj;
  - 1.3 Në Parcela Kadastrale Nr. P-70917026-00143-5 me kulturë Kullosë e Klasës 4 në sipërfaqe prej **00.87.77ha** në Zonën Kadastrale Doganaj.
2. Prona e paluajtshme e komunës së Kaçanikut e përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi, e destinuar për zhvillim ekonomik, i jepet në shfrytëzim afatgjatë Ofertuesit ROYAL BENVERAGE LL.C me numër të protokollit 01Nr. 104/02-9281/24 të datës 18.04.2024, e përzgjedhur si Oferta ekonomikisht me e favorshme nga komisioni vlerësues.
3. Parcelat Kadastrale të potencuar si në pikën 1.në Zonën Kadastrale në Doganaj të theksuar si në pikën 1 të këtij vendimi, jepen në shfrytëzim afatgjatë për **Nëntëdhjetenëntë (99) vjet** kompanisë me aktivitet të biznesit, Prodhim i pijeve freskuese AR-Cola, **ROYAL BENVERAGE LL.C**, për zhvillimin e aktivitetit të biznesit, si vijon:  
Hapjen e fabrikës për prodhimin e ujit të ambalazhuar natyral mineral, në paketim PET, qelq dhe bidon në volume të ndryshme, duke filluar nga 0,25L deri 10 L. Sipas ofertës, kjo kompani

synon të jetë moderne me një teknologji të avancuar, duke plotësuar standardet për siguri të ushqimit ISO dhe ato të ushqimit HACCAP. Vlera e investimeve në ofertë është 5,500,000.00€, me numër të punësuarve ekzistues 167. Në fazën fillestare 30 punëtorë të lidhur me prodhimin, synon të rritë kapacitetet e prodhimit dhe numrin e të punësuarve në fazën e dytë, hapësirat e objekteve prodhuese, përfshirë edhe objektet e nevojshme përcjellëse. Përveç shitjes në tregun vendor, kjo kompani, në fazën e dytë parasheh dhe planifikon që një sasi e mjaftueshme do të përcjellët për eksport në vendet e rajonit dhe me larg. Përfitimi financiar i komunës: Rritja e punësimit në komunën e Kaçanikut në ZK Doganaj dhe fshatrave përreth, pagesat nga taksat e ndryshme (leja ndërtimore, taksat e rregullta komunale, tatimi në pronë). Në përfitim financiar të komunës, kompania ka potencuar në ofertë, se Komuna do të përfitoj një brend botëror, i cili do të veproj brenda territorit të komunës së Kaçanikut, nga i cili do të jetë i pranishëm në tryezat evropiane dhe botërore.

4. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, Nuk mund të bartet në shfrytëzim të personave të tretë.
5. Obligohet Kryetari i Komunës që të nënshkruajë Kontratë me kompaninë fituese ROYAL BENERAGE LL.C, si në pikën 1. të këtij vendimi- me në të cilën kontratë do të përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese, konform nenit 19, paragrafit 3.2 të Ligjit Nr. 06/L-092 – Për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
6. Për Mbikëqyrjen dhe realizimin e kontratës do të kujdeset, Kryetari i Komunës, i cili konform dispozitave të nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-092 – Për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, obligohet të paraqet raport 6 mujor Kuvendit të Komunës dhe raport të veçantë për realizimin dhe përmbushjen e qëllimit të dhënies së pronave komunale në shfrytëzim si dhe veprimet tjera (masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit- përs hirë edhe rekomandimin për shkëputje të kontratës) që duhet të merren në rast të mosrealizimit të planit dinamik dhe kushteve të përcaktuara në kontratë.
7. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës. Kryetari i Komunës është i obliguar të njoftoj Kuvendin e Komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës si dhe të jap propozime për destinimin e pronës në të ardhmen, konform pikës 2 të nenit 23 të Ligjit me numër të theksuar si më lartë.
8. Konform pikës 3 të nenit 23 të ligjit të theksuar si në pikën 4 të këtij vendimi, pas përfundimit të kontratës për shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, mund të vazhdohet afati i dhënies në shfrytëzim në bazë të performancës.
9. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.
10. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:** MAPL; Kryetari i Komunës (përmes Zyrës së Kryetarit njoftohet pala); Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit; Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit; Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillim Rural dhe Pylltari; Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli